

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD” SHPK**

KREU I
Dispozita te Pergjithshme

Sot, në datën 05 Tetor 2021 (dymijë e njezete e nje) personi i meposhtem:

- I.** **Kliti GRAMOZI**, atesa Demir, i datelindjes 12.11.1996, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajes i Leternjoftimit nr. Personal J61112041B.

Ne cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire pivate, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me perjegjesi te kufizuar, me emertimin **“INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD” SHPK**.

KREU II
Ortaku, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore


Neni 1
EMRI

- 1.1** Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes “shoqeri me perjegjesi te kufizuar” dhe mban emrin **“INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD” SHPK**.
- 1.2** Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar bazohet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga ortaku në shoqëri. Çdo ortak zoteron një kuotë të vetme në shoqëri.

Neni 2
Objekti

Shoqëria **“INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD” SHPK** do te kete objekt veprimtarie:

- 1-Sherbime ligjore te ndryshme, keshillim juridik, perfaqesim ligjor per persona fizik dhe juridik, perpara te gjitha organeve te administret shteterore, apo cdo zyre ose institucioni privat.
- 2-Perfaqesim ligjor perpara cdo shkalle te gjyqesorit ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj per sa lejohet nga legjislacioni ne fuqi.
- 3-Redaktim aktesh te ndryshme ligjore per te perfaqesuarit prej saj ne lidhje me ceshtje administrative, civile, penale etj.
- 4-Asistence ligjore per shoqerite tregtare, perpilimi i akteve administrative qe rregullojne marredheniet e shoqerise tregtare brenda saj dhe/ose me te tretet.



5-Sherbim ndermjetesimi me persona apo subjekte te tjere per te arrire nje marreveshje sa me te favorshme ne lidhje me pasuri te paluajtshme. Transaksione financiare si dhe cdo veprim tjeter te kerkuar nga te interesuarit si dhe cdo lloj keshillimi ligjor te mundshem ne permajtje te ligjit/ligjeve ne fuqi per profesionin e asistent juristit,juristik,avokatit,ndermjetesuesit,permbaruesit etj... .

6-Zhvillimi i kurseve profesionale te asistences juridike etj....

7-Kryerjen e investigimeve ne funksion te sherbimeve te lartpermendura ne bashkepunim me institucionet shteterore,zyrat e dedektiveve privat,OJF-ve etj... gjithmone brenda kuadrit ligjor ne fuqi.

**Neni 3
Kohëzgjatja**


- 3.1** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2** Shoqeria “**INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD**” SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKB-se.

**Neni 4
Zyra Qendrore**

- 4.1** Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njesia Bashkiake nr.9, Rruga e Barrikadave, Banesa tek ish Kinema 17 Nentori, (Galeria), Kati i trete, Zyra Nr.5, Tiranë.
- 4.2** Gjate veprimitarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjisacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.
- 4.3** Nr. kontakti tel. per shoqerinë:**00355(0)693149684**.
- 4.4** Adresa E-mail e shoqërisë : **bernardinternacional@gmail.com**

**KREU III
Neni 5
Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

- 5.1** Kapitali i regjistruar i shoqerise është **1.000 Lek** (nje mijë lek), i barabarte me 1 (nje) kuote. Kontributet e ortakut perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2** Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes se ortakut te vetem te shoqerise, llogaritet ne raport me kontributin, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:



+ Salih Sulejmani 1

| Nr. | Emri i Ortakut | Kuota | Kontributi i ortakeve ne kapital (leke) | Perqindja ne kapital |
|-----|----------------------|----------|---|----------------------|
| 1. | Kliti GRAMOZI | 1 | 1.000 | 100 |
| | Totali | 1 | 1.000 | 100 % |

- 5.3 Kontributi per sa me siper eshte nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 6 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakut ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosi zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuari nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

KREU IV Neni 7 Transferimi i Kuotave

- 7.1 Transferimi (perfshire shitjen dhe/ose dhurimin; dhe/ose cedimin; dhe/ose kalimin) inter-vivos te kuotave te shoqerise tek pale te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere ekzistues, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te parashikuara ne nenin 7.2 me poshte.
- 7.2 Ne rast se nje ortak (ne vijim i quajtur Ofriuesi) kerkon te transferoje disa ose te gjitha kuotat ,ose kontributet e zoteruara prej tij ne shoqeri, ortaket e tjere (ne vijim te quajtur Ortaket e tjere) gezojne te drejten e parablerjes mbi kuotat qe ofrohen per transferim (ne vijim te quajtura Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:
- a. Ofriuesi do t'u dergoje fillimisht ortakeve te tjere ekzistues nje njoftim me shkrim (poste-rekomande) ku te percaktohet numri i kuotave te ofruara, si dhe cmimin e kuotave te ofruara, emrin e bleresit dhe kushtet e tjera kontraktore te transferimit (ne vijim referuar si oferta) duke ftuar se pari ortaket ekzistues te blejne keto kuota te ofruara.
 - b. Ortaket e tjere kane te drejte te blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, ne perpjestim me perqindjet e zoteruara, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofriuesit brenda nje afati 30 (tridhjete) ditor pas marries se njoftimit te ofriuesit me poste rekomande.
- 7.3 Ne rast se nje apo disa nga ortaket ekzistues nuk perggjigen gjate afatit te mesiperm apo perggjigen ne menyre negative, atehere ofriuesi eshte i lire ne

transferimin e kuotave ne favor te paleve te treta pa kufizim, me kushte te njejtë si ato te parashikuara ne oferten e mesiperme.

- 7.4 Parashikimet sa me siper nuk zbatohen ne rastin kur kuotat transferohen ndermjet ortakeve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur ne vije te drejte te ortakeve ekzistues (femije, bashkeshorte).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruvesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gjëzues të të drejtave mbi kuotën e tij; pamvarësish parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.

- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë nga shoqeria likujdimin e saj, ne vlore te percaktuar nga ekspertet perkates.

Kreu V


Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendosi, por, pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;



1

- m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera te parashikuara nga "Ligi per Shoqerite Tregtare" dhe "Statuti".

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me leter-rekomande me njoftim-marrje te derguar ne adresen e ortakeve apo poste elektronike :(E-mail) (adresa te depozituara rregullisht nga ortaket prane administratorit dhe E-mail te pasqyruar ne ekstraktin e shoqerise ne te dhenat vullnetare te tij te pakten 7 dite perpara mbledhjes). Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përparrë datës së caktuar për mbledhjen përvèç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithe ortaket që zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbate ne menyre te qarte daten, diten, kohen, vandin dhe rendin e dites te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejtë procedure njoftimi që pëershkruehet me siper.

Neni 10 Kuorumi i nevojsphem


- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve te zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaquesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zoterojnë jo me pak se 51 (pesedhjete e nje) % të kapitalit te shoqerise.
- 10.2** Në rastin e marrjes së vendimeve te jashtezakonshme, që kerkojne një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaquesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zoterojnë jo me pak se 51(pesedhjete e nje) % të kapitalit te shoqerise.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjete) ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Përgjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme me ane te votes pro te nje shumice prej 3/4 të ortakëve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme rregullisht te mbledhur për ceshtje te rendesishme qe kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ,etj... .
- 11.2** Asambleja e Përgjithshme mund te marre vendime te zakonshme me anen e votes pro te shumices se ortakeve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, rregullisht te mbledhur, dhe vecanerisht mbi ceshtjet e me poshtme:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - c) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jetë administratori i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe nje person tjeter për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Neni 12
Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejte vote në përpjeshëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotërueshit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi.



A large, handwritten signature is written across the bottom of the page, spanning from approximately [315, 725] to [825, 975]. The signature is written in blue ink and appears to be a personal or professional name. To the right of the signature, the number '1' is handwritten in a smaller font.

- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.


Kreu VI
Administratori
Neni 13
Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve te Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "**INTERNACIONAL ESTUDIO LEGAL BERNARD” SHPK:**

Kliti GRAMOZI, atesia Demir, i datelindjes 12.11.1996, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes me nr. Personal J61112041B, per një afat 5 (pese)vjeçar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti pranë Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me siper dhe ligjit tregtar ne fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me siper, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetenca:
- (i) do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
 - (ii) do te nenshkruaje cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
 - (iii) do te hape llogari ne emer te Shoqerise ne cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj,
 - (iv) do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh ,apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijoje nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuara shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
 - (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise – duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Fikret Gramizi", is written over the bottom right corner of the page. A small number '1' is located at the end of the signature line.

- (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (vii) do te pergartise dhe nenshkuaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (viii) do te krijoje nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjt nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xi) do te pergartise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Shtypshkronjes;
- (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xiii) do te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.
- (xiii) Do te administroje adresat dhe kontaktet e ortakeve (tel, E-mail). Ne cdo rast ortaket jane te detyruar qe menjehere pas cdo azhornimi te kontakteve te tij (nr.tel, E-mail, adrese shtepie) te njoftoje administratorin me shkrim, ne te kundert mban perjegjesi per cdo dem te shkaktuar nga mosnjoftimi ne kohe.


Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me siper, ka të drejtë të ngrejë padi përparrë gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjt ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15 Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuani ose mund të vuajë nga çrrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16 Kufizimet në Veprimet e Administratorit



- 16.1** Administratori nuk do të lidhi marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim, i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit per shoqerite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqerise, ne baze te kuorumi te kerkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VII
Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë


Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimitarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 te ligjit per shoqerite tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e shoqerise.

17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

17.3 Administratori eshte i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me perjashtim te rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata qe i dergon njoftimin QKB-se.

Neni 18



A handwritten signature in blue ink is written over a grid of blue lines on a white background. The signature is fluid and appears to be in a local language. A small number '1' is located at the bottom right corner of the grid area.

Njoftimet

- 18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër-porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19 Dispozita kalimtare

- 19.1 Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 19.2 Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor te zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 19.3 Viti finanziar zgjat 12 (dymbedhjete) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4 Ne fund te cdo viti finanziar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 19.5 Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare ne fuqi, te azhornuar.


Neni 20 Dispozita perfundimtare

- 20.1 Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimitarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me një statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 20.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do t'i referohen legislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare, me permabjtje dhe vlere te njejtë juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga palet pa asnjë rezerve.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

+ KLITI GRAMOZI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Kliti Gramozzi". The signature is enclosed in a large, roughly circular blue ink outline. Above the signature, the text "+ KLITI GRAMOZI" is printed in a small, bold font. To the right of the signature, the number "1" is written vertically.